



**RAPORT
MONITORIMI I SEKTORIT TË
MJEDISIT NË KOMUNËN E
PRIZRENIT**

2024

MAJ, 2025



RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT- 2024

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771

Maj, 2025

PËRMBAJTJA :

HYRJE

GJETJET E RAPORTIT

- 1 Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
Statistikat Kryesore - 2024:**
- 2 Korniza ligjore**
- 3 Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**
- 4 Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
Raportet mjedisore në nivelin lokal**
- 5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave**
- 6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**
- 7 Licencimi dhe lejet mjedisore**
- 8 PËRFUNDIME**
- 9 REKOMANDIMET**

HYRJE

Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunitatet e Kosovës. Disa nga komunitetet kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr.2003_3 për pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunal, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit.

Njëherësh kanë theksuar se burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore. Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e Planifikimit dhe Menaxhimit Mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prizrenit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Sektori i Mjedisit dhe i Menaxhimit të Mbeturinave që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Stafi i SMMM përbëhet nga 5 zyrtarë; udhëheqësi i sektorit, zyrtari për mjedis, zyrtari për menaxhimin e mbeturinave, inspektori për mjedis dhe shërbyesi në sportel (arkëtar). Teksa në kuadër të Drejtorisë së Inspektorateve është i angazhuar edhe inspektori komunal për çështje mjedisore.

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Shërbimeve Publike	
Sektori	Po	Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave	5
Zyrtarët	Po	Udhëheqësi i Sektorit të Mjedisit dhe Mbeturinave Zyrtar mjedisor Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave Inspektori për mjedis Shërbyes në sportel (arkëtar)	5
Drejtoria	Po	Drejtoria e Inspektoriateve	
sektori	Po	Inspektori Komunal për çështje mjedisore	1

Sipas zyrtarëve të anketuar numri i angazhuar i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, sipas tyre shërbyesit civil në SMMM kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, ku nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) kanë dhënë vlerësimin 4.

SMMM ka njoftuar se gjatë vitit 2024 janë organizuar dy trajnime për punonjësit e këtij sektori rreth kornizës ligjore. Një prej tyre ishte trajnimi mbi “Veprimet për zbutje dhe përshtatje të ndryshimeve klimatike për autoritetet lokale dhe anëtarët e Qendrës Komunale për Zhvillim të Gjelbër të Prizrenit dhe Suharekës”, ndërsa tjetri ishte trajnimi “Ndërmarrjet Komunale për Trajnime të Autoriteteve Lokale” në kuadër të projektit SLCA (Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën), i financuar nga ADA (Agjencia Austriake për Zhvillim) dhe implementuar nga UNDP, në partneritet me Komunën e Prizrenit dhe Komunën e Suharekës.

Ndërsa gjatë vitit 2024 nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMM, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër, por sipas tyre në këtë pjesë vlen të theksohet që kuadër të Projektit Rrjetit Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimeve (RCDN), i fokusuar në bashkëpunimin dhe komunikimin për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve, ekspertë nga shtetet e rajonit (Maqedonia e Veriut, Kroacia, Shqipëria, Mali i Zi, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina) kanë realizuar kërkime kombëtare për bashkëpunimin ndërmjet pushteteve lokale dhe kompanive të shërbimeve publike.

Ky hulumtim ka identifikuar përvojat e kompanive rajonale dhe komunave për gjendjen aktuale të bashkëpunimit dhe mundësitë për krijimin e mekanizmave që do të përmirësojnë këto raporte dhe do të nxisin ofrimin më efektiv të shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve.

Teksa nga zyrtarët e DI-së është raportuar se nuk janë organizuar ndonjëherë trajnime rreth kornizës ligjore dhe çështje mjedisore nga niveli qendror, komunal apo organizata të tjera.

Stafi i SMMM gjatë vitit 2024 ka treguar se për menaxhimin e çështjeve mjedisore janë mbështetur në këto dokumente ligjore:

1. Ligji Nr. 02/L-30 për menaxhimin e Mbeturinave
2. Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave 2023
3. Plani Master 2014-2023 Nr. 01/011-161014, 03 shtator 2015
4. Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Statistikat Kryesore - 2024:

Kategoritë	Numri
Zyrtarë të angazhuar në SMMM	5
Trajnimet rreth kornizës ligjore	2
Trajnimet sipas fushës mjedisore	0
Udhëzuesve Profesional për Planifikimin dhe Menaxhimin Mjedisor	4

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Prizrenit, përkatësisht SMMM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2014-2015
2. Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave 2023
3. Plani Master 2014-2023 Nr. 01/011-161014, 03 shtator 2015
4. Ligji Nr. 02/L-30 për Menaxhimin e Mbeturinave
5. Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
6. Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit

7. Ligji NR. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
8. Ligji nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit
9. Ligji Nr.04/ L-147 për ujërat e Kosovës
10. Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma

Zyrtarët e SMMM të Komunës së Prizrenit kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar. Mangësitë kryesore ligjore të identifikuar nga Komuna e Prizrenit kanë qenë të lidhura me menaxhimin e mbeturinave dhe përfshijnë: mungesën e ndarjes në burim, e cila nuk zbatohet dhe shkalla e riciklimit është shumë e ulët (pothuajse 5%); hedhjen e paligjshme të mbeturinave, me rreth 15.1% të mbeturinave të gjeneruara që hidhen në mënyrë të paligjshme, duke shkaktuar ndotje dhe rreziqe për shëndetin publik; mungesën e ndërgjegjësimit publik për menaxhimin e mbeturinave dhe përfshirjen e pamjaftueshme të komunitetit; si dhe kapacitetet financiare të kufizuara për menaxhimin efektiv të mbeturinave.

Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me 3-4, nga 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Sikurse në vitet para paraprake, rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizim me qëllim që ato ti përgjigjen nevojave të kohës. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis ka skaduar në vitin 2018 dhe nuk është hartuar plani i ri.

Programet mjedisore sipas SMMM edhe përgjatë vitit 2024 kanë përfshirë fushën vetëdijesimit ku kanë shënuar ditë të ndryshme mjedisore si Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit më 5 Qershor, në fshatin Poslisht, ku kanë bërë pastrimin e hapësirës së jashtme përreth objektit të

SHFMU "Hasim Maliqaj" si dhe në lokacionin në dalje të fshatit ku është identifikuar një pikë ilegale e mbeturinave që u eliminua për t'u rikthyer në hapësirë të gjelbër e të pastër, janë shënuar edhe Dita e Tokës, Dita pa Makina dhe është bërë mbështetja e organizatës së grave me të cilat ky sektor ka realizuar aktivitete të përbashkëta.

Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2024 sipas SMMM përfshijnë mirëmbajtjen e vazhdueshme të hapësirave publike përmes kontratave të DSHP-së dhe identifikimi i pikave ilegale të mbeturinave dhe pastrimi i tyre.

Sipas zyrtarëve, hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit janë në përputhje me strategjitë mjedisore në fuqi.

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Prizreni ka raportuar se inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe hartimi i raporteve përkatëse realizohet, SMMM në këtë rast harton raporte tre, gjashtë mujore dhe vjetore në të cilat përshkruhen masat dhe aktivitetet e ndërmarra.

Përsëri edhe këtë vit gjendja e deponive të mbeturinave sipas zyrtarëve nuk monitorohet nga ana e Komunës por kjo është përgjegjësi e Kompanisë së Menaxhimit të Deponive të Kosovës e cila gjatë këtij viti ka qenë në proces të hartimit të projektit për hapjen e deponisë së re në Landovicë dhe rehabilitimin e asaj ekzistuese, ndërkohë që nuk janë zhvilluar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis.

Kompanisë së Menaxhimit të Deponive të Kosovës e cila gjatë këtij viti ka qenë në proces të hartimit të projektit për hapjen e deponisë së re në Landovicë dhe rehabilitimin e asaj ekzistuese, ndërkohë që nuk janë zhvilluar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore, përgjegjësia i është adresuar Drejtorisë së Inspektorateve, është raportuar se ka raste të ndryshme të identifikimit të çrregullimeve mjedisore të cilat janë adresuar tek organet kompetente komunale dhe MMPHI. Kjo drejtori po ashtu ka raportuar se gjatë vitit 2024 ka pasur vetëm 2 (dy) gjoba të shqiptuara për moszbatim e Ligjit të Mjedisit.

Në lidhje me inspektimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit zyrtarët e DI-së në Komunën e Prizrenit kanë raportuar se e realizojnë sipas kompetencave ligjore dhe se çdo javë hartohen raporte të inspektimit të zbatimit të kësaj kornize në lidhje me:

1. Inspektimin e operatorëve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale.
2. Inspektimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.
3. Monitorimin dhe inspektimin e kompanisë publike “Eko Regjioni” për zbatimin e planit të punës sipas kontratës.

Në lidhje me monitorimin e zonave të mbrojtura, gjendja e pyjeve sipas DI-së paraqet vështirësi për shkak të faktit që në të gjithë komunën e Prizrenit është vetëm një inspektor mjedisor.

Teksa kjo drejtori ka treguar se ka pasur raste të identifikimit të çrregullimeve mjedisore nga aktivitete të personave fizik ose juridik, raste këto për të cilat është informuar ministria dhe organet tjera kompetente.

E njejta procedurë është realizuar edhe me rastet e tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara në të cilat raste janë shqyrtuar së bashku me inspektorët e KPMM-së dhe MMPHI-së.



INSPEKTIMI DHE RAPORTIMI

- Inspektme: **Nuk ka numër të specifikuar**
- Raporte: **3, 6 - mujore dhe vjetore**
- Inspektorë: **1**
- Shkelje: **2 gjoba për shkelje të ligjit mbi mjedisin**



MONITORIMI I ZONAVE TË MBROJTURA

- Monitorimi: **Nuk realizohet**
- Stafi: **I pamjaftueshëm**
- Zonat e Mbrojtura: **Vështersi në monitorim**

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Prizrenit nuk ka raportuar për ndonjë përmirësim të ndjeshëm sa i përket grumbullimit dhe menaxhimit të dhënave mjedisore, përfshirë ajrin, ujërat e tokën. Komuna e Prizrenit nuk ka sistem të monitorimit të dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ndërsa në lidhje me parashikimin dhe paralajmërimin e hershëm të vërshimeve dhe thatësirave, Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë në Prizren ka hartuar vetëm dokumentin “Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë” në të cilin janë të përcaktuara zonat e thata dhe zonat në të cilat mund të ketë vërshimet. Teksa paralajmërimet për qytetarët realizohen në bazë të të dhënave që Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës publikon për komunat në faqen e saj zyrtare.

Administrata lokale nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, DSHP-ja nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, pasi që në SMMM siç është cekur më lartë janë të angazhuar vetëm 5 punonjës.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Prizrenit bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të pamjaftueshëm. Njëjtë është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore, sipas tyre vetëm Asociacioni i Komunave për Menaxhimin e Mbeturisë mbetet një organizim i rëndësishëm që mundëson shkëmbimin e përvojave mes komunave dhe nxitjen e iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e menaxhimit të mbeturisë.

Sipas tyre niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel të kënaqshëm, ku përfshihen aktivitete të ndryshme për promovimin e mbrojtjes së mjedisit, si dhe subvencionimi i tyre për realizimin e programeve të tyre për çështjet mjedisore. Njëherësh është theksuar se hartimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturisë, është zhvilluar përmes konsultimit publik, dhe pjesëmarrjes së OJQ-ve dhe shoqatave tjera, ku janë marrë propozimet dhe janë përfshirë në draft Rregullore.

Njëherësh është theksuar se hartimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, është zhvilluar përmes konsultimit publik, dhe pjesëmarrjes së OJQ-ve dhe shoqatave tjera, ku janë marrë propozimet dhe janë përfshirë në draft Rregullore.

Licencimi dhe lejet mjedisore

Raportimi i Komunës mbi numrin e licencave dhe lejeve mjedisore aktive, nuk është i plotë ngase është ofruar vetëm lista e lejeve mjedisore të lëshuar nga DSHP-ja për vitin 2024, teksa sa i përket licencave Drejtoria e Bujqësisë nuk kanë raportuar se si organ kompetentë sipas tyre është Agjencia e Pyjeve të Kosovës me drejtoritë e tyre rajonale.

Pra sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në vitin 2024 janë lëshuar gjithsejtë 99 leje mjedisore. Sa i përket lejeve ujore nuk janë ofruar të dhëna nga SMMM.

Data	Lëndë të bartura në 2024	Lëndë të pranuar	Gjithsejtë	Lëndë të shqyrtuara
Janar – Dhjetor 2024	11	130	141	99

Të pa zgjidhura	Të aprovuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Të bartura për vitin 2025
33	99	6	3	0

PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij raporti janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, duke pohuar se ato pasqyrojnë gjendjen reale në sektorin e mjedisit, bashkë me mundësitë për të ngritur dhe përmirësuar çështjet mjedisore në këtë komunë. Burimet njerëzore dhe financiare sipas tyre nuk janë të nivelit të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Komuna e Prizrenit ka krijuar organ përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, por kapacitetet njerëzore brenda këtij organi janë të pamjaftueshme si në aspektin kuantitativ ashtu edhe në atë profesional, ndërkohë që nuk ka pasur as aktivitete për fuqizimin e tyre në raport me kornizën aktuale ligjore dhe në periudhën raportuese nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMM.

Njohuritë e stafit komunal rreth kornizës mjedisore nuk janë të nivelit më të lartë, derisa përcaktimi i sfidave me të cilat ata ballafaqohen si rrjedhojë e mangësive ligjore në fushën e mjedisit ka qenë i pamundur për shkak të mos listimit të tyre nga punonjësit e SMMM.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematik, për faktin se nuk ka organizim të mirëfilltë në këtë aspekt; përkatësisht, rrjedha aktuale e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit aktualisht e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Niveli i inspektimit si dhe hartimi i raporteve përkatëse lidhur me zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatimit të strategjive mjedisore mbetet i paqartë për shkak të mos shpalosjes së të dhënave të plota në këtë drejtim, derisa është pranuar se në tregues të caktuar nuk ka monitorim.

SMMM në Komunën e Prizrenit ende nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore, për shkak të mungesës së resurseve teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në hartimin e politikave publike vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm. Bashkëpunimi me shoqërinë civile në hartimin e politikave lokale mbetet i pamjaftueshëm, ashtu sikurse edhe pjesëmarrja e publikut në hartimin strategjive lokale. Ndërsa sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në vitin 2024 janë lëshuar gjithsejtë 99 leje mjedisore.

Sa i përket lejeve ujore nuk janë ofruar të dhëna nga SMMM.

REKOMANDIMET

-Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në SMMM;

-Të organizohen trajnime për punonjësit e SMMM rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore;

-Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;

-Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre;

-Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor;

-Të fillojë sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave mjedisore;

-Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore; dhe

-Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-së synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.